

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Have Haliti dhe Fillim Skoro anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesional Leonita Lajqi, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve M.D.1., M.D.2. dhe N.P. nga fsh. ..., Komuna e Gjakovës, i akuzuari M.D.1., për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarit M.D.2. dhe N.P. për shkak të veprës penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 329 par. 2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-DKR, si dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit M.D.1., av. A.M., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë, PKR.nr.169/16 të datës 28.08.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datë 21.12.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen, si të pabazuara, ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-DKR, si dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.D.1., av. A.M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë, PKR.nr.169/16 i datës 28.08.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore DKR në Gjakovë, PKR.nr.169/16 të datës 28.08.2017, i akuzuari M.D.1., është shpallur fajtor për veprën penale të grabitjes nga neni 329 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 12.10.2016, e tutje, si dhe dënim me gjobë në shumë prej nga 600 €, të cilin gjobë është i obliguar ta paguajë në tri këste në afat prej 3 muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, po qese dënimin me gjobë nuk e paguan, i njëjti i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve, duke i llogaritur për çdo ditë të kaluar në paraburgim shumën prej 20 €.

Të akuzuarin M.D.1., gjykata e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, kurse paushallin gjyqësorë në shumën prej 100 € të paguajë në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarin M.D.1. gjykata e ka obliguar që të dëmtuarës V.Z., t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar prej 11.385,32 €, në emër të parave të gatshme të përfituara me kryerjen e veprës penale, si dhe 699,95 €, në emër të telefonit IPHON 6 në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara V.Z., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, për pjesën tjetër të mbetur të dëmit dhe atë për dy dukatë të ballit është udhëzuar në kontest civil.

Konform nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së, të akuzuarit M.D.2. dhe N.P., gjykata i ka liruar nga akuzat, për shkak se në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarit M.D.2. dhe N.P. bien në llogarinë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore në Gjakovë-DKR, vetëm sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit, për të akuzuarit M.D.2. dhe N.P., me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.D.1., av. A.M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim më të ulët apo çështje të kthehet në rigjykim.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën PPA/I.nr.507/2017 dt. 30.11.2017, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore DKR në Gjakovë, kurse aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim, sa i përket të akuzuarve M.D.2. dhe N.P., ndërsa të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.D.1..

Gjykata e Apelit konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPKR-së, mbajti seancën e kolegjit, në të cilën prezantuan, i akuzuari M.D.1. av. A.M., ndërsa nuk prezantuan Prokurori i Apelit, e dëmtuara V.Z., të akuzuarit M.D.2. dhe N.P., të cilët janë ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe të mbrojtësit të akuzuarit M.D.1., pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-DKR për pjesën liruese të aktgjykimit dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.D.1., janë të pa bazuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.D.1., pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, arsytimi i aktgjykimit është në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit. Gjykata e shkallës parë, nuk ka vërtetuar saktësinë e provave kundërtënëse, dispozitivi i

aktgjykimit nuk përmban përshkrimin e veprimeve konkrete të cilat përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i akuzuari, në dispozitiv të aktgjykimit thuhet se “i akuzuari M.D.1., duke përdorur forcën pasi më parë ka shkuar në marketin te “NN”, pronë e të dëmtuarës V.Z., kinse për të blerë disa gjëra ushqimore dhe pasi e identifikon të dëmtuarën V.Z., të njëjtën e përcjellë dhe në momentin kur ajo arrin të hyjë në banesën e saj ia kapë çantën nga krahu duke e përdorur forcën”, ky është vetëm një perceptim i prokurorisë dhe nuk bazohet në asnjë fakt apo provë, se e dëmtuara nuk ka arritur me e identifikuar të akuzuarin M.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, pretendimet ankimore të mbrojtësi të akuzuarit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë më shkëlje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk qëndrojnë. Dispozitivi i aktgjykimit është hartuar sipas dispozitave të neni 365 par. 1 nën par 1.1 të KPPK-së, në dispozitiv janë shënuar faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, për të cilat i akuzuari është shpallur, si dhe ato fakte i ka shtjelluar në detaje në arsyetim të aktgjykimit, duke i vlerësuar drejtë të gjitha provat e administruara një nga një, si dhe duke dhënë arsye se pse këto fakte i konsideron si të vërtetuara, andaj pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se aktgjykimi është përfshirë me shkëlje esenciale të dispozitave të procedurës penale, është i pa bazuar.

Mbrojtësi i akuzuarit në ankesë pretendon se me aktgjykimin e ankimuar gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, se me provat që janë administruar nuk vërtetohet fakti se i akuzuari natën kritike të ketë hyrë në marketin pronë e të dëmtuarës gjëja për të blerë gjëra ushqimore, dhe pastaj të ketë përcjellë të dëmtuarën për t’ia grabitur çantën, se nuk është vërtetuar lartësia e dëmit të shkaktuar, se e dëmtuara gjëja kishte në çantë 11.385,32 €, para të gatshme të pazarit ditor për dy ditë për gjashtë lokale të saja, e cila për këtë shumë ka prezantuar disa prova në seancë, nuk përkon me shumën prej 11.385,32 €, sepse e dëmtuara në seancë ka prezantuar raportet prej dt. 01.10.2016 dhe 02.10.2016, nga të cilat rezulton, se më dt. 01.10.2016 janë bërë blerje me kartelë për dhjetë raste, mirëpo nga i njëjti raport rezulton se paratë e regjistruara në raportin fiskal të shitoreve si pazar ditor nuk janë inkasuar në arkë me para kesh, por janë regjistruar në mënyrë të drejtë për drejtë në konton e xhirollogarisë të marketit “Te NN”, ka pasur blerje me kartelë, po ashtu ekziston edhe pagesa në bankën ProCredit Bank për datat në fjalë të paguara në mënyrë të drejtë për drejtë nga kartelat e konsumatorëve në xhirollogarinë e marketit “Te NN”, e këto shuma janë të regjistruara edhe në raportin fiskal të arkave të lokaleve afariste dhe nga kjo rezulton se në këtë rast kemi paraqitje të dyfishtë të humbjeve, kinse i është shkaktuar dëme të dëmtuarës dhe për këtë dispozitivi i aktgjykimit është i kundërligjshëm, sepse e detyron të akuzuarin që t’i kompenzon dëmin të dëmtuarës në shumë prej 11.385,32 €, për këtë gjykata është dashur që të caktojë ekspert financiar. Se dëshmia e të dëmtuarës është kontradiktore me dëshminë dëshmitarit B.B., e cila ka thënë se pasi është përshëndetur me fqinun e tij B., në hyrje të banesës i njëjti ka shkuar tek automjeti i tij, atëherë ka ndodhur rasti i grabitjes nga ana e pasme nga një person, e ka ngrehur për çante deri te automjeti i tretë në parking gjersa është rrëzuar në tokë, në momentin kur ka rënë në tokë, ka arritur që i akuzuari t’ia heqë çantën me forcë dhe është larguar, por e njëjta ka bërë titur “o ma kanë vjedhur çantën”, kurse dëshmitari B.B., ka thënë se ka qenë duke dalë nga banesa dhe të dëmtuarën e ka parë në tokë të shtrirë dhe është përqendruar që ta zë personin që e ka parë me çantë në dorë dhe ka filluar të vrapojë pas tij por pa sukses, gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e ka bazuar në dëshminë e të dëmtuarës dhe të dëshmitarit A.Z. dhe B.B., të cilat kanë qenë të njëanshme.

Gjykata e Apelit, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, i ka administruar të gjitha provat e propozuara duke dëgjuar në cilësinë e të dëmtuarës V.Z. dhe dëshmitarët A.Z. dhe B.B., ka administruar

CD-në nga incizimet e kamerave të lokalit fitnesit që gjendej përballë marketit “ Te NN”, si dhe shikimin e kamerave të marketit “ Te NN”, ka dëgjuar të akuzuarin M.D.1., si dhe ka bërë leximin e raportit të arkës fiskale për datën 1.10. 2016 të N.T.P dhe raportin fiskal të nxjerrë në ora 23,08 min. për 6 lokalet e shitjes “ Te NN”, si dhe leximin e raportit të arkës fiskale për datën 2.10. 2016 të N.T.P dhe raportin fiskal të nxjerrë në ora 23,32 min. për 6 lokalet e shitjes, si dhe vërtetimin mbi pagesën e bërë në emër të IPHON 6 në shumë prej 699.95 €, si dhe shikimin e librave të shitjes për datë 1 dhe 2.10.2016, ashtu që nga të gjitha këto prova në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka gjete se i akuzuari M.D.1. me datë 2.08.2016 rreth orës 23:30, në Rr. “Anton Qeta” në Gjakovë, para hyrjes se banesës se të dëmtuarës V.Z., me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme të përvetësojë sendet e huaja të luajtshëme, i akuzuari më parë ka shkuar në Marketin “Te NN” pronë e të dëmtuarës dy herë gjëja për të blerë gjëra ushqimore, pasi e identifikon të dëmtuarën, të njëjtën e përcjellë, e kur ajo arrin të hyrja e banesës duke e përdorur forcën ia kap çantën prej krahu, e dëmtuara për kundër rezistencës rrezohet, i akuzuari ja kap çantën në të cilën kishte 11.385.32 €, një telefon IPHON 6 të cilin e ka blerë për 699,95 €, dy dukat të ballit me vlerë prej 1100 €, si dhe dokumentet personale dhe largohet nga vendi i ngjarjes, kurse e dëmtuara vrapon pas tij së bashku me dëshmitarin B.B., i cili rastësisht ka qenë duke dalë nga banesa, por nuk kanë arritur ta kapin grabitësin.

Prandaj, nuk është kontestuese se ditën kritike ka qenë ditë e diele, e dëmtuara V.Z., në mbrëmje ka shkuar së bashku me djalin e saj A.Z., në lokalet e saj që gjinden në Qendrën Tregtare “Nertili” në Gjakovë, rreth orës 23,30 min. se në atë kohë bëhet pranimi dhe dorëzimi i pazarit ditor në lokalet e saj, pastaj bashkë me djalin janë kthyer te banesa e tyre në Rr. “Anton Qeta “ e kur ka zbritur nga vetura në hyrje të banesës djali i saj ka kërkuar parking, i akuzuari M.D.1. i ka dalë nga krahu i majtë ia ka ngre çantën, e ka ngre zvarrë deri të vetura e tretë, e kur është rrezuar në tokë i akuzuari për kundër rezistencës se të dëmtuarës ka arritur që me forcë t’ia merr çantën, në atë moment më zë të lartë e dëmtuara ka bërë tite “O ma kanë vjedhur çantën”, kurse fqiu i saj B.B., e ka dëgjuar se ka qenë afër dhe i është bashkangjitur për të ndjekur grabitësin por ai ka arritur të largohet.

Se nuk është kontestuese ditën kritike i akuzuari dy herë ka hyrë herë në marketin “ Te NN”, pronë e të dëmtuarës, gjëja për të blerë gjëra ushqimore, gjë që vërtetohet edhe nga kamerat e sigurisë se lokalit, pasi e identifikon të dëmtuarën, të njëjtën e përcjellë, e kur ajo arrin të hyrja e banesës duke e përdorur forcën ia kap çantën, se e dëmtuara e ka identifikuar të akuzuarin pas shikimit të video inqizimit në marketin “ Te NN”, si dhe pas shikimit në inqizimin e kamerave të fitnesit ku janë parë lëvizjet e personit që e ka grabitur duke e përcjellë, por edhe në polici e ka përshkruar fizionominë e grabitësit gjatësinë e tij, por pas shikimit të videove ka qenë 100% e sigurt se ka qenë M.D.1., të cilin shumë mirë e ka identifikuar edhe në shqyrtimin fillestar posa e ka parë, kurse të akuzuarit tjerë nuk i ka parë.

Se nuk është kontestuese se e dëmtuara në çantë ka pasur 11.385.32 €, një telefon IPHON 6 të cilin e ka blerë 699,95 €, si dhe dokumentet personale, se e dëmtuara i ka paraqit në gjykatë si prova kuponat fiskal, raportin e shitjes për datën 1 dhe 2. 10. 2016 për 6 lokalet, si dhe është bërë krahasimi i pazareve ditore me librat e shitjes, ku këto raporte përputhen edhe me formularin mbi deklarinimin e TVSH-së, si dhe nga libri i shitjes të marketit “Te NN” për datën 1 dhe 2. 10.2016, ku shuma e të hollave ka qenë 11.385.32 €, duke iu zbritur pagesat me kartel bankare në shumë prej 362 €, kurse sa iu për ketë dy dukat të ballit me vlerë prej 1100 €, që e dëmtuara ka pretenduar se i ka pasur, nuk ka mund të argumjente me prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, e me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, është udhëzuar në kontest civil.

Se i akuzuari në polici ka pranuar se ka kryer veprën penale duke i përshkruar veprimet e tij në detaje, e të cilën fakt e ka mohuar në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor, por gjatë ballafaqimit në shqyrtimin gjyqësor me deklaratën e dhënë në polici të cilën e ka pranuar se e ka nënshkruar, është mbrojtur duke thënë se nuk i kujtohet se çka ka thënë në polici se ka qenë i maltretuar nga policia, në fillim nuk ka qenë mbrojtësi prezent por ka ardhur më vonë, kurse deklarata e dhënë në polici është marrë konform dispozitave ligjore, është e nënshkruar nga i akuzuari dhe mbrojtësi, se më parë nuk është ankuar as në prokurori se ka qenë i maltretuar nga policia dhe nuk ka kërkuar trajtim mjekësor, kurse nga masat e fshehta përcaktimin e hartografisë nga raporti i kompanisë vala është vërtetuar se natën kritike, i akuzuari telefonin e ka pasur aktiv në zonën ku është kryer grabitja .

Nga këto arsye, si dhe arsyet e dhëna në aktgjykimin e ankimuar nga gjykata e shkallës së parë, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se gjendja faktike gabimisht është vërtetuar, nuk qëndrojnë. Kurse konkludimet e gjykatës se shkallës se parë, janë të drejta dhe të ligjshme, kanë mbështetje në provat e administruara. Gjykata e shkallës se parë, provat e administruara drejtë i ka vlerësuar dhe në përputhshmëri me nenin 361 të KPPK-së, ashtu që duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e cekura më lartë, si dhe arsyet e theksuara në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës se parë, në menyrët të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, duke bërë vlerësimin dhe analizën e provave të administruara, ka nxjerr konkludime të drejta dhe të ligjshme duke i arsyetuar të gjitha faktet relevante, për të cilat e ka shpallur fajtor, arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës se parë, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.D.1., pretendon se me aktgjykimin e ankimuar është shkelur ligji penal, por në ankesë nuk i përcakton bazat e kësaj shkelje.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, gjykata e shkallës se parë, drejtë ka aplikuar ligjin penal, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor, për veprën penale penale të grabitjes nga neni 329 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit, duke e shqyrtuar çështjen, sa i përket ankesës se mbrojtësit të akuzuarit mbi bazat tjera, ka shqyrtuar çështjen edhe përkitazi me vendimin për dënimin ku mbrojtja ka propozuar që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ulët.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës se parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë se dënimit, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat konform nenit 73 të KPK-së, mbrojtësi i të akuzuarit nuk thekson ndonjë rrethanë tjetër posaçërisht lehtësuese, e cila kishte me ndikuar që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës se parë. Rrethanat lehtësuese që i ka marr parasysh gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit të akuzuarit M.D.1., si sjelljet e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, moshën relativisht të re, edhe pse i akuzuari është i moshës madhore, i aprovon edhe kjo gjykatë. Për këto arsye Gjykata e Apelit, konstaton se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, ashtu që dënimi i shqiptuar duhet të jetë si preventive për parandalimin e luftimit të suksesshëm të këtij lloji të veprave penale që janë në rritje dhe të rrezikshme për shoqërinë tonë, se me këtë dënim do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale dhe se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, nuk ka gjetur prova se të akuzuarit M.D.2. dhe N.P. kanë kryer veprën penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 329 par. 2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, andaj të akuzuarin me të drejtë e ka liruar nga aktakuza në mungesë të provave.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë, se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë për të akuzuarit M.D.2. dhe N.P., të cilët janë liruar nga aktakuza, nuk qëndrojnë, sipas prokurorisë gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar nuk e ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara, kur të akuzuarit i ka liruar nga aktakuza, se aktgjykimi i ankimuar është bazuar në deklaratën e të dëmtuarës V.Z. e cila e ka përshkruar mënyrën se si i është grabitur çanta, por i akuzuari M.r i ka përshkruar në detaje edhe veprimet e të akuzuarve M.D.2. dhe N.P., e sipas të akuzuarit M.r i akuzuari N.P. ka qenë ideatori se si duhet vepruar me rastin e grabitjes, kurse i akuzuari M.D.2., ka ofruar në shërbim veturën e tij për t'u larguar nga vendi i ngjarjes.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka marrë aktgjykimin lirues për të akuzuarit M.D.2. dhe N.P., se për secilën prove të administruar ka dhënë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, se të akuzuarit natën kritike nuk kanë marrë pjesë në grabitje, vërtetohet nga dëshmia e të dëmtuarës V.Z. dhe dëshmitarve A.Z. dhe B.B., të cilët njëjtë kanë deklaruar se natën kritike në vendin e ngjarjes ka qenë vetëm një person, të cilat dëshmi përputhen edhe me provat materiale që janë administruar, se nga raporti i hyrje daljeve telefonike, nuk vërtetohet se të akuzuarit kanë zhvilluar biseda telefonike nga ai vend ku është kryer vepra penale, nga hartografia dhe shikimi i video incizimet të vendit të ngjarjes nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë qenë në vendin e ngjarjes nuk vërehen lëvizjet e tyre, ashtu që me asnjë provë nuk është vërtetuar, se të akuzuarit kanë qenë natën kritike kur është kryer vepra penale e grabitjes nga i akuzuari M.r në vendin e ngjarjes, prokuroria në ankesë nuk ka përmendur prova tjera për veç atyre që janë vlerësuar në aktgjykimin e ankimuar, andaj gjykata e shkallës së parë, drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, duke marrë aktgjykimin lirues për të akuzuarit M.D.2. dhe N.P..

Prokuroria pretendon se gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar ka bërë shkeljen e ligjit penal, kur të akuzuarit M.D.2. dhe N.P. i ka liruar nga aktakuza, se në veprimet e të akuzuarve manifestohen elementet e veprës penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 329 par. 2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar ligjin penal, kur të akuzuarit i ka liruar nga aktakuza, sepse prokuroria nuk ka paraqitur asnjë fakt se me aktgjykimin në fjalë është shkelur ligji penal, kur gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka liruar nga aktakuza.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorisë nuk janë të bazuara, se gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, bazuar në provat e administruara dhe të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, e të cilat i përkrah edhe kjo gjykatë, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve nuk qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, se me provat e administruara nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, prandaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar ligjin penal, kur të akuzuarit i ka liruar nga akuzat, konformë nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 401 të KPPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.540/17 i datës 21.12.2017

Procesmbajtësja

Leonita Lajqi

Anëtarët e kolegjit

1.Have Haliti

2.Fillim Skoro

Kryetari i kolegjit

Xhevdet Abazi